



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PORTI DETAR SHA SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. 564/6 .Prot.

Sarandë, më 21.11.2025

PROCESVERBAL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti: "Urë kalimi dhe detektorë".

Procedura: "E hapur e thjeshtuar"- Mall, (elektronikë).

Fondi limit: : 5.000.000 (pesë milion) Lek,pa TVSH

Burimi: Vetëfinancim

Afati: 57 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës.

Referenca: Programi ekonomik i Shqipërisë për vitin 2025.

CPV: Barriera sigurie-34928310-4, Pajisje sigurie - 35113000-9, Detektorë metali - 35124000-9.

Udhëzimi I APP (Manuali) Nr.1 datë 03.06.2025 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike"

KODI OUTPUT: 0000000

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", I ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM- së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **PORTI DETAR SHA SARANDË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*
- c. Formularin e Ofertës Ekonomike, sipas Shtojcës 1;*
- d. Listat e Çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi:

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 - Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, sipas Shtojcës 9.

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: **100 000 lekë (njëqindë mijë) Lek.**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Formularin e ofertes sipas Shtojcës 1 dhe Listat e Çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 3:

Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" I ndryshuar dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, çdo operator ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të ofertës së tij edhe formularin e ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 3 të Dokumenteve Standarte të Tenderit.



2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Të jetë i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjtë ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën në njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qenë se lloji i procedurës është “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, gërma “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.....”;

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin (sipas QKB-së).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.



Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Duke qenë se autoriteti kontraktor është njësi e autoriteteve vendore e gjen të arsyeshme që pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë ofertues në këtë procedurë prokurimi ta kushtëzojë me shlyerjen në kohë të taksave vendore të parashikuara me ligj.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i



përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (furnizimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për furnizime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqes ISO 9001-2015.

Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas ISO/IEC 9001 2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente. Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën Certifikatë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente). Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar dhe të provohet garantimi i standardeve të kërkuara në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht mallra cilësore që plotësojnë kërkesat të AK-së dhe është i përkushtuar për përmirësimin e vazhdueshëm.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO IEC 20000-1:2018 (ose ekuivalente) për “Menaxhimin e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën



të jenë certifikuar dhe të provohet garantimi i standardeve të kërkuara në sistemin e menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit. Është kërkuar kjo certifikatë pasi ofron një kuadër për menaxhimin e shërbimeve IT në mënyrë efektive, duke përfshirë instalimin dhe mirëmbajtjen e paisjeve dhe sistemeve.

Autoriteti vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve dhe certifikatat e kërkuara kanë lidhje të drejtpërdrejtë me procedurën e prokurimit. Përmbushja e standartit ISO 9001, ISO/IEC 27001, ISO 20000-1 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilesisë, menaxhimin e shërbimeve IT dhe zbatimin e sigurisë së informacionit të shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Pajisjet e ofruara si ura metal dhe detektor ka një ndërfaqe web me qëllimin konfigurimet dhe monitorimet në distancë të urës nëpërmjet ndërfaqes web. Në këto kushte për të siguruar kushtet me optimale për zbatimin e sigurisë së informacionit dhe menaxhimin e saj nevojitet si standarte.

2.3.4 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar prej 2 (dy) muajsh nga shpallja e njoftimit të kontratës, të pakten 5 (pesë) punonjës nga të cilët:

- 1 (një) inxhinier elektronik ose informatik ose telekomunikacioni
- 1 (një) teknik ose specialist i certifikuar për detektimin e metaleve (e vlefshme).

Një punonjës mund të disponojë më shumë se një certifikim.

Për çdo punonjës të certifikuar të përfshirë në projekt, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomati;
- Certifikatat përkatëse;
- Listëpagesat sipas formatit E-Sig 025, të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve që vërtetojnë se punonjësi ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik 3 (tre) muajt e fundit shpalljes së njoftimit të kontratës.

*Përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 9, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Operatori ekonomik i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 5-b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë që zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa prej 5 punonjësish është kërkuar me qëllim që operatori të disponojë fuqi puntore e cila do të kryejë proceset e punës brenda afatit kohor për shkak të urgjencës që paraqet rritja e nivelit të sigurisë Portuale. Është e nevojshme që të angazhohen 5 punonjës për të siguruar një instalim dhe operim të shpejtë të sistemeve të sigurisë. Rritja e numrit të punonjësve është



thelbësore për të përmbushur kërkesat e emergjencës dhe për të siguruar që punimet të realizohen pa vonesa, duke përfshirë instalimin e sistemeve të avancuara si ura dedektimi metalesh dhe skanera dore. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një koordinim dhe punë të përsheptuar, duke garantuar që këto sisteme të bëhen funksionale duke mbrojtur kështu institucionin nga çdo kërcënim të mundshëm dhe duke përmbushur nevojat urgjente të sigurisë që kërkohen nga situata. Gjithsesi, ky numër punonjësish është minimal që operatori ekonomik ofertues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësor, të qëndrueshme dhe jetëgjatë në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi për minimumi 1 (një) inxhinier elektronik ose informatik ose telekomunikacioni:

Prania e të paktën një inxhinieri elektronik ose informatik ose telekomunikacioni është e domosdoshme për sigurinë dhe cilësinë e projektit. Inxhinieri do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen teknike të projektit, duke përfshirë instalimin e pajisjeve, konfigurimin e sistemeve, dhe sigurimin që të gjitha pajisjet të funksionojnë siç duhet sipas specifikimeve teknike. Për më tepër, duke marrë parasysh natyrën sfiduese të projektit inxhinieri do të luajë një rol kritik në planifikimin dhe ekzekutimin e sigurt dhe efikas të këtyre detyrave.

Argumentimi për minimumi 1 (një) teknik ose specialist i certifikuar për detektimin e metaleve (e vlefshme):

Duke qene se pajisja urë kontrolli për detektimin e metaleve dhe pajisja skaner dore për tu vendosur në gjendje optimale pune do të ketë të nevojshme që të kryhen instalimet përkatese si gjatë fazës fillestare të instalimit të saj ashtu dhe gjatë periudhës së garancisë do të duhet që operatori ekonomik të ketë minimalisht një teknik apo specialist të certifikuar për detektimin e metaleve (e vlefshme).

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për pajisjet e mëposhtme:

- **Urë kontrolli për detektimin e metaleve**
- **Metal detektor dore**

Në rastin e paraqitjes së autorizimit të distributorit duhet të vërtetohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi. (Nëse dokumentacioni është në gjuhë të huaj duhet e përkthyer dhe noterizuar si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit).

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 40, pika 6-b, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Është gjykuar si kriter i domosdoshëm, pasi ka të bëjë me informacion e nevojshem se ku prodhohet malli dhe mundësinë reale për të bërë furnizimin, nëpërmjet autorizimit që i jepet operatorit ekonomik ofertues.

2.3.6 Operatori ekonomik për çdo produkt të ofruar duhet të paraqesë në SPE katalogun ose skedën teknike ku të tregohen dhe të diktohen qartë karakteristikat teknike të mallit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Projektin Teknik të ngarkuar në SPE.



Në katalogun ose skedën teknike duhet të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, ku të gjëjmë pasqyrim për parametrat teknikë të produktit (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, përveç elementëve teknik specifik, termave në anglisht që përdoren ndërkombëtarisht, që janë vendosur në specifikimet teknike me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të nenit , të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 40, pika 6-b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të cilat janë të domosdoshme në realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë rast është shumë e rëndësishme si dëshmi për plotësimin e kërkesave dhe specifikimeve teknike verifikimi i të dhënave të produktit në katalog për të garantuar cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim në vëmendje se:*

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do të jetë kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:



Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP-së, si dhe të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas shkresës Nr.2065 Prot, datë 12.04.2022.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Specifikimet Teknike hedhur në SPE www.app.gov.al ME EMËRTESEËN: Projekti Teknik dhe Specifikimet Teknike.pdf

Në përfundim të miratimit të specifikimeve teknike, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **09.12.2025, ora 12:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik në faqen e APP-së si dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **Blerje pajisje për sigurinë në Portin Detar Sarandë "Urë kontrolli dhe Detektor dore"**, Njësia e Prokurimit përcaktoi anëtarin e njësive të prokurimit R.A.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali:

- Dokumentat standarte të tenderit
- Projekti Teknik dhe Specifikime Teknike
- Njoftimi i Shkurtuar i Kontratës
- Preventiv Memec
- Plani i zbatimit

NJËSIA E PROKURIMIT